REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2628, datë 29.10.2015

Për

"Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit "Rregullore për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare""

Këshilli Drejtues (*KD*) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 29.10.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit "Rregullore për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare".

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;
- Dokumenti**:** "Rregullore për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare".

Adresa: Rr. "Abdi Toptani",
Godina Torre Drin, K. IX, Tiranë
Tel : ++ 355 4 2259 571
Fax : ++ 355 4 2259 106
www.akep.al
info@akep.al

BAZA LIGJORE:

1. Pika 10 e nenit 9 dhe neni 38, të Ligjit Nr. 46, datë 7.5.2015 "Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë" ***(ligji nr. 46/2015);***
2. Pika 3 e nenit 114 të Ligjit Nr. 9918, datë 19. 05. 2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ***(ligji nr. 9918)***;
3. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" i ndryshuar ***(ligji nr. 8485)***;
4. Rregullore e brendshme e AKEP, miratuar me Vendim nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë SH I LL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Ligji Nr. 46/2015, 2015 "Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë" është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 7.05.2015. Ky ligj zëvendëson Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në bazë të nenit 67 të tij, Ligji 46/2015 hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ligji 46/2015 është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.85, datë 26.05.2015.

2. Bazuar në përcaktimet e ligjore të mësipërme, AKEP me Urdhërin nr. 1482, datë 23.06.2015, ka ngritur një Grup Pune për përgatitjen e kuadrit rregullator të shërbimeve postare sipas Ligjit 46/2015. Grupi i Punës ka përgatitur "Rregullore për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare" për këshillim publik me palët e interesuara. Dokumenti i përgatitur ka si objekt të krijojë kuadrin rregullator për përmbushjen e kërkesave ligjore të pikes 10 te nenit 9, dhe nenit 38 të Ligjit 46/2015.

3. Në përgatitjen e dokumentit Grupi i Punës ka marrë në konsideratë përvojën në vendet e BE dhe rajonit si dhe kushtet Shqiptare në ofrimin e shërbimit postar dhe dokumenti i përgatitur përmban kryesisht:

   a) Procedura dhe kushtet e plotësimit dhe dërgimit të të dhënave statistikore postare;
   b) Verifikimi dhe përdorimi i të dhënave;
   c) Formularët që duhet të plotësohen me të dhenat e kërkuara dhe dërgohen në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare.

4. Të dhënat statistikore postare dhe financiare periodike të përcaktuar në këtë rregullore, do të shërbejnë për grumbullimin, evidentimin dhe përdorimin e të dhënave statistikore dhe financiare mbi shërbimet postare, për të nxjerrë përfundimet e nevojshme për analizën dhe tendencat e zhvillimit në tregun postar si dhe përcaktimin e treguesve matës të sektorit postar.

5. Dokumenti "Rregullore për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare" është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm në tregun e shërbimit postar. Dokumenti nxirret për këshillim publik dhe AKEP mirëpret komente nga palët e interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësine e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 10, të ligjit 46/2015,

V E N D O S:

1. Të miratojë nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit "Rregullore për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare", sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Proçedura e këshillimit publik të kryhet për periudhën 29.10.2015 - 29.11.2015. Komentet e palëve te interesuara të paraqiten me shkrim në adresën zyratre të AKEP brenda datës 29.11.2015.

3. Ky Vendim dhe Dokumenti "Rregullore për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare", të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**